

URDHËR
Nr. 548, datë 22.11.2022

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 365, DATË 10.8.2022, “PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE, NËNPRODUKTEVE TË TYRE, MATERIALIT BIOLOGJIK, EMBRIONEVE, MISHIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE NGA HUNGARIA, LETONIA, UKRAINA, RUMANIA, ITALIA, GJERMANIA, LITUANIA, MOLDAVIA, SLOVAKIA, SERBIA, ESTONIA, BULLGARIA, POLONIA DHE MAQEDONIA E VERIUT”

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 365, datë 10.8.2022, “Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Hungaria, Letonia, Ukraina, Rumania, Italia, Gjermania, Lituania, Moldavia, Sllovakia, Serbia, Estonia, Bullgaria, Polonia dhe Maqedonia e Veriut”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca